



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKA KOSOVA	
GJYKATA E APELIT PRISHTINË			
GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA KLINË OSNOVNI SUD PEÇ OGARANAK KLINA			
Përpunuar - Primipieno: 21.07.2023			
Kopje Origjinal, Nr.	Gr.	Shitje Përdor	Vlera Vlerësimi

Numri i lëndës: 2022:212091

Datë: 26.07.2023

Numri i dokumentit: 04523692

Ka. nr. 284/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e Kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit subjektit ekonomik NTSH “Baci Petroll”, B.I. Njësia në fshatin Zllakuqan – Komuna e Klinës, me pronar Agron Colaj, për kundërvajtje nga neni 13 par. 2 sanksionuar me nenin 19 par. 8 pika 8.3 e Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme, lidhur me nenin 7 të UA Nr. 09/2020, për kontrollin dhe Cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri - subjektit ekonomik NTSH “Baci Petroll”, B.I. Njësia në fshatin Zllakuqan – Komuna e Klinës, me pronar Agron Colaj, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.345/2022, të datës 01.06.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe nenit 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 2, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, më datë 19.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga i pandehuri subjekti ekonomik NTSH “Baci Petroll”, B.I. Njësia në fshatin Zllakuqan – Komuna e Klinës, me pronar Agron Colaj, ndërsa **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 345/2022, i datës 01.06.2023, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut, me numër të Ref. 19/2022 të datës 12.10.2022, me numër të Protokollit 6199-19, me aktgjykim, K.nr.345/2022, të datës 01.06.2023, të pandehurin NTSH “Baci Petroll”, B.I. Njësia në fshatin Zllakuqan – Komuna e Klinës, me pronar Agron Colaj, e ka shpall përgjegjës sepse:

-me datë 05.10.2022, në kohë të pacaktuar, gjatë inspektimit të kryer nga ana e Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në bashkëpunim me Trupën Inspektuese "Sierra Lab" të autorizuar nga MINT (për vlerësimin e konformitetit të karburanteve të lëngëta të naftës), tek subjekti ekonomik NTSH "Baci Petroll", B.I. në pikën shitëse me pakicë të NDN-së, Njësia në fshatin Zllakuqan – Komuna e Klinës, janë marrë mostrat e karburantit Dizel dhe Benzinë për të verifikuar cilësinë e derivateve dhe pas analizës ka rezultuar derivati i testuar Dizel me numër të Raportit 520/2022-TI-M, i datës 06.10.2022, Jo Conform me parametrat e përcaktuara me dispozitat Rregullative, Raporti i inspektimit tjetër sipas ankesës së të pandehurit, sipas ri – testimit (super analizës) me numër 547/2022-TI-M, i datës 12.10.2022, ka rezultuar përsëri Jo Conform me dispozitat Rregullative, produkti nuk ishte konform me parametrat minimale të Pikës së ndezjes 55°C të përcaktuara me nenin 7 të Udhëzim Administrativ Nr. 09/2020 për kontrollin dhe cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës, por pika e ndezjes ishte nën parametrin minimal dhe atë 33.5 °C,-

-me ç veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 13 par. 2 sanksionuar me nenin 19 par. 8 pika 8.3 e Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme, e i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 2500(dymijepesëqind)€, të cilën gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjoba e shqiptuar dhe shpenzimet e lartcekura do të arkëtohet me dhunë sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Me të njëjtin aktgjykim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5(pesë)€, në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, konform nenit 59 të LK-së.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë i pandehuri NTSH "Baci Petroll", B.I. Njësia në fshatin Zllakuqan – Komuna e Klinës, përmes pronarit Agron Colaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale – ligjit material me të cilin është paraparë kundërvajtja dhe vendimit mbi sanksionin kundërvajtës – konfiskimit të dobisë pasurore dhe shpenzimeve të procedurës kundërvajtëse si dhe kërkesës pasurore juridike, në të cilën në mes të tjerash thekson se: aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje nga neni 138 par. 1 të LK-së. Gjykata e shkallës së parë ka cenuar dispozitën e nenit 139 par. 1 pika 8 të LK-së, pasi që aktgjykimin e bazon në provë të pa pranueshme, pasi që Raporti i Inspektoratit të MINT-së, i hartuar pas vlerësimit të mostrave ishte i pa saktë dhe jo real dhe se është e pamundur që realisht të matën parametrat minimal të pikës së ndezjes në 55°C, ndërsa Mauna që transporton karburantet e kompanisë "Alba" SHPK - Viti, garanton cilësinë e karburanteve sipas UA Nr. 09/2020. Po ashtu konsideron se ka vërtetim të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike shkelje të neni 141 par. 2 i LK-së.

I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesa të aprovohet në tërësi ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të Ndryshohet dhe të nxjerrët aktgjykimi lirues ose të Anulohet dhe çështjen ta kthej ne rivendosje dhe rigjykim.

Kolegji i Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtës, duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktgjykimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur është e pa bazuar dhe refuzohet, ndërsa aktgjykimi i goditur vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji konstatoj se gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, në bazë të deklaratës së Pronarit të NTSH "Baci Petroll" - Agron Colaj, të dhënë në Procesverbalin e seancës së datës 08.05.2023, i cili ka deklaruar se në rastin konkret i

pandehuri furnizohet nga "Alba" SHPK - Viti, duke konsideruar se përgjegjësinë e mban në këtë rast furnizuesi, andaj lut gjykatën ta ketë parasysh këtë rrethanë, në bazë të Procesverbalit të inspektimit Nr. 00679/22, të datës 05.10.2022, Procesverbalit të inspektimit Nr.00325/22, të datës 07.10.2022, Raportit Inspektues të "Sierra Lab" me Nr. 520/2022-TI-M të datës 06.10.2022, i cili ka rezultuar Jo Conform sa i përket pikës së ndezjes, ku kufiri është 55°C, ndërsa i njëjti sipas rezultatit ka qenë 39°C, si dhe në bazë të Raportit Inspektues të "Sierra Lab" me Nr. 547/2022-TI-M të datës 12.10.2022, i cili po ashtu ka rezultuar Jo Conform sa i përket pikës së ndezjes, ku kufiri është 55°C, ndërsa i njëjti sipas rezultatit ka qenë 33.5°C, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës, padyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse, nga neni 13 par. 2 sanksionuar me nenin 19 par. 8 pika 8.3 e Ligjit Nr. 08/I-018 1 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishme, sepse ka tregtuar derivate të naftës, i cili nuk është konform rregullativës ligjore të përcaktuar me UA Nr. 09/2020, për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse, ndërkaq sipas ligjit është i obliguar që të iu garantoj dhe shes klientëve të tij naftë dhe produktet e saj, me cilësi ashtu siç e parasheh ligji.

Kolegji, konstatoi se aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë, konkret, përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje kundërvajtëse dhe në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar e ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar si dhe ka dhënë arsyet e qarta për vërtetimin e tillë të fakteve.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e të pandehurit të ushtruar përmes pronarit Agron Colaj, janë të pabazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka aplikuar ligjin material si dhe drejtë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Kolegji ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer dhe shkallën e përgjegjësisë si dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i pandehuri nga kryerja e veprave në të ardhmen si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave të tilla kundërvajtëse.

Kolegji i kësaj gjykate i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore, mirëpo të njëjtat i vlerësoi se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme si dhe pa ndikim sepse në shkresë të lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plot dhe të drejtë.

Kolegji konstatoj se, Gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procedurës nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kurse gjopa e shqiptuar ndaj të pandehurit konform nenit 35 të LK-së, në shumë prej **2500(dymijepesëqind)€**, konsiderohet se është përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, peshës së veprës së kryer, si rrethanave në të cilat është kryer vepra kundërvajtëse, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin e aktgjykimit të goditur.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 2 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Ka. nr. 284/2023, me datë 19.07.2023

KRYETARJA E KOLEGJIT,

Azra Cakolli



A. Cakolli